

VENDIM
Nr. 6, datë 23.2.2015

**PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË “UJËSJELLËS-KANALIZIME
VLORE SHA”**

Në zbatim të nenit 14, germa “h”, nenit 15 dhe nenit 32/1, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” dhe rregulloren e ERRU-së, “Për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimit për dënimin e kundërvajtjeve administrative në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, miratuar me vendim të KKRR-së, nr. 1, datë 6.1.2012, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë” sh.a. për ushtrim të veprimtarive të grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e trajtimin e ujërave të ndotura pa licencën përkatëse, dënohet me gjobë në shumën 300 000 lekë.

2. Ngarkohen Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore për ndjekjen e procedurave në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi